



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 30.

Prishtinë, më 14.11.2018 në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Blerta Deliu -Kodra, Armend Zemaj, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Zenun Pajaziti, Adem Hoxha dhe Donika-Kadaj-Bujupi.

**Munguan:** Fikrim Damka, Ismet Beqiri dhe Milaim Zeka.

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit e tjerë: Përfaqësuesi nga GIZ dhe mediat.

**Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu –Kodra, kryetare e komisionit**

**Kryetarja,** pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit me këtë;

**Rend Dite:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstaton se rendi i ditës u miratua.

**Kryetarja** tha se në shqyrtim i kemi dy Projektligje të cilat janë të parapara me agjendën evropiane.

## 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

**Kryetarja**, lidhur me këtë projektligj, tha se çështjet të cilat adresohen dhe rregullohen në këtë projektligj, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, ndërsa lidhur me amendamentet e Komisionit Funkcional paraqiti dy propozime:

Propozoi që amendamenti 1 i Komisionit Funkcional të riformulohet si vijon:

### **Në nenin 1 shtohet një paragraf i ri si vijon:**

Ky ligj është në përputhshëri me direktivën 214/42/ Bashkimi Evropian i Parlamentit Evropian dhe Këshillit të dt. 3.04.2014 mbi ngritjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave të krimit në BE.

### **Amendamenti 2**

Propozojmë që mos të përkrahet amendamenti 8 i Komisionit Funkcional, i cili amendament parasheh; **Në nenin 5, në paragrafët 6.1 dhe 6.2 në rreshtin e tretë, fjala pasuri zëvendësohet me fjalën pronë dhe teksti vazhdon si në Projektligj.**

Konstaton se zëvendësimi i fjalës pasuri me fjalën pronë është vendosur në kontekst më të gjerë në tekstin e projektligjit dhe mund të ndërrojë qëllimin e Projektligjit, është dhënë definicioni i fjalës pasuri dhe nuk kemi definicion të fjalës pronë, pra propozoj që teksti të mbetet si në projektligj, e jo siç e kanë propozuar Komisioni Funkcional.

Kryetarja hapi diskutimin dhe ftoi anëtarët e Komisionit të deklarohen lidhur me këtë projektligj.

**Armend Zemaj** tha se pajtohet me dy propozimet e dhëna që lidhen me direktivën, kurse pjesa tjetër kërkon ndoshta një analogji rreth definicionit “Pronë dhe Pasuri” sigurisht është në harmoni edhe me emrin, por nuk kam parë që kanë dhënë një shpjegim rreth këtij definicioni dhe kjo mund të ngrit dilema në implementim.

Ky ligj nuk ka plotësua pritjet tona që kanë të bëjnë me zgjerimin e kompetencave që meren me konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pa ligjshme. Akoma me këtë ligj tentohet të avancohen disa kompetenca që flasin rreth procedurave për konfiskimin e pasurisë, por substanca e kërkesës sonë permanente është që konfiskimi i pasurisë së

fituar në mënyrë të pa ligjshme të jetë e sanksionuar në mënyrë shumë të saktë si pjesë e legjislacionit tonë.

Kjo po mbetet e zbrazët edhe me këtë ligj dhe personalisht do të votoj kundër, se nuk mendoj të bëhem pjesë vetëm e ndryshimeve kozmetike duke tentuar që përshtatshmërisht të kemi ngritje të efikasitetit pa efektivitet të implementimit dhe kjo është vetëm plotësimi i një norme dhe në praktikë nuk do të gjejë zbatueshmeri, sepse më shumë merret me procedurat e menaxhimit të pasurisë së sekuestruar, se sa vetë me konfiskimin e pasurisë së pa luajtshme.

**Ismajl Kurteshi** tha se ky ligj i cili është kërkuar një kohë të gjatë në Kuvend ka ardhur si rezultat i presionit nga jashtë dhe tani janë bërë disa ndryshime kozmetike edhe pse po flitet për zgjerimin e kompetencave.

Këtu në fakt nuk ka zgjerim të kompetencave, ma tepër ka disa formalitete të cilat këtë ligj nuk e bëjnë funksional dhe nuk ia mundësojnë që përmes ligjit të kryhen veprimet e caktuara, pra të konfiskohet pasuria që është fituar në mënyrë të pa drejtë, ose për mes keqpërdorimit të pushteteve, prandaj si të tillë nuk mund ta përkrahi dhe kërkoj që ligji t'i kthehet Qeverisë dhe atje të bëhet një ligj i mirëfilltë, i cili vërtet do të mundësojë konfiskimin e pasurisë së të gjithë atyre që pasurin e kanë bërë në mënyrë të pa ligjshme.

**Fatmire Kollçaku** i përkrah opinionet e dy parafolësve dhe tha se mendon që ky ligj është një ndër ligjet kryesore që ka të bëjë edhe me kërkesat e BE-së. Mirëpo megjithatë nëse ne nuk kemi arritur që në Kuvend ta plotësojmë dhe ndryshojmë dhe t'i implementojmë ato ndryshime që i kemi propozuar brenda në Komisionin për Legjislacion, atëherë mendoj që duhet t'ia kthejmë Qeverisë që me të vërtet të na sjellë një ligj të kompletuar sepse po flasim për zgjerimin e kompetencave dhe pasi që ta bëjnë plotësim- ndryshimin e duhur do të jemi të gatshëm që ta votojmë, prandaj do ta votoj kundër.

**Zenun Pajaziti** tha se ne, në Kuvend, nuk është që kemi pasur ligje të përkryera të shumta, jemi në procedurë në plotësim dhe ndryshim të disa ligjeve me radhë për shumë arsye, për arsyen se kemi pasur kërkesa që kemi pasur nevojë me i harmonizua me legjislacionin e BE-së dhe pse realiteti në vend po ndërron dhe po ka arsye të ndryshme dhe për shkaqe të ndryshme. Jo vetëm për shkak të kërkesës së madhe që kemi për këtë Projektligj, si një prej vërejtjeve kryesore të Komisionit Evropian për këtë ligj, por për shkak të rikthimit të debatit të mirëfilltë në Kuvend për me plotësuar dhe ndryshuar dhe për t'ia dhënë dritën jeshile. Nuk e besoj që nëse e kthejmë ligjin në këtë fazë një ditë Qeveria do t'na sjellë një model të përkryer që në vetëm do ta votojmë dhe do të vazhdojmë me tutje.

Kompetencat tona na mundësojnë që me procedura dhe debat me ndryshua projektligjin, mendoj që ne sot duhet me bërë debat dhe me ndryshuar aq sa kemi kompetenca projektligjin dhe me çuar përpara brenda Kuvendit të Kosovës. Ne jemi deputetë dhe kemi përgjegjësit tona dhe nuk është mirë që para mediave të flitet ndryshe, kurse ne Komision ndryshe. Mendoj se nuk duhet me e vonuar , por me ja dhënë dritën jeshile dhe

me dhënë sinjalin se jemi të gjithë për këtë Projektligj dhe me e bërë një version sa me të mirë të mundshëm në Kuvend.

**Visar Ymeri** tha se ky Ligj është shumë i rëndësishëm dhe e mbulon një fushë jashtëzakonisht delikate për Republikën e Kosovës duke e pasur parasysh nivelin real të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në fusha të caktuara, veçanërisht për këtë fushë që po flasim sot përputhja formale me direktivat e BE-së nuk do të thotë domosdoshmërisht që është e dobishme për Republikën e Kosovës, duke marrë parasysh rrethanat e ndryshme që ne jetojmë krahasuar me vendet anëtare të BE-së, veçanërisht në këtë fushë nuk mendoj që Kosova mund të jetë e krahasueshme me ndonjë vend të BE-së dhe në këtë mënyrë masat e njëjta me ato vende nuk do të thotë se prodhojnë rezultatin e duhur në Kosovë, përkundrazi mund ta krijojnë iluzionin se ne kemi ligje, ndërkohë që ato bëhen të pa zbatueshme, jo pse janë ligje domosdoshmërisht të këqija, por pse në to krijohet hapësira të mos zbatueshmërisë.

Në këtë drejtim ne ligjet duhet t'i shohim nga perspektiva e integriteteve evropiane nganjëherë më shumë si frymë, se sa si mjet. Ky ligj nuk e mundëson as për së afërmi ndërtimin e një mekanizmi jashtëzakonisht të rëndësishëm në luftën kundër krimit dhe korrupsionit nëse njëkohësisht nuk ka mekanizma e mundësi të konfiskimit të pasurisë së pa ligjshme nga persona të caktuar në Republikën e Kosovës, prandaj vota ime do të jetë abstenuese dhe po te kishte qenë e mundur ligji t'i kthehet Qeverisë dhe jam i vetëdijshëm që ky komision nuk mund ta bëjë një gjë të tillë, por seanca ta bëjë, pra ta refuzojmë miratimin e një ligji i cili nuk e adreson as për së afërmi çështjen për të cilën kemi kërkesa nga BE-ja, sepse nuk kërkon nga ne me miratuar ligje, por na kërkon me luftuar krimin dhe korrupsionin, dhe ne nuk e bëjmë këtë duke miratuar ligje, të cilat e dimë apriori që nuk e adresojnë këtë çështje dhe nuk do ta mundësojnë luftimin e krimit dhe korrupsionit.

**Donika Kadaj- Bujupi** tha se ne mund të pajtohemi të gjithë rreth substancës së ligjit, mirëpo ju kisha lutur për mirëkuptim për fazën në të cilën jemi, sepse nga Zyra e BE-së është kërkuar me urgjencë një pako e ligjeve të miratohen. Nuk është hera e parë që ne kemi ligje të cilat për arsye të ndryshme janë aprovuar ndërsa zbatimi nuk lenë shumë për t'u dëshiruar.

Vazhdimisht këta tre muajt e fundit na është përmendur që i kemi dy apo 3 ligje të cilat kanë mbetur peng dhe të cilat sipas tyre duhet të kalohen. Nuk është folur për substancën apo zbatimin sepse nuk do koment se çdo ligj duhet të zbatohet në momentin që bëhet i plotfuqishëm. Mirëpo në këtë fazë nuk konsideroj që është në rregull me ia kthye Qeverisë dhe me e vonuar procesin, përmbajtjen e ligjit mund ta diskutojmë në Kuvend dhe për të cilën jam ihtarë që edhe deputetët nga opozita të i japin amendamentet e tyre dhe ta bëjmë Ligjin si duhet. Por me e kthye ne parim dhe me e refuzuar në parim, mendoj që do të jetë një argument shtesë për të gjithë ata zëra që për arsye politike sot po na vonojnë procesin e liberalizimit. Mos të keqkuptohemi ne të gjithë pajtohemi se i kemi plotësuar kriteret dhe kjo nuk është e drejtë se këto 3-4 projektligje nuk janë aspak çështje e kritereve të parapara, se kriteret i kemi plotësuar dhe është përmbyllur ai proces.

Por për faktin që kërkohen si shtesë dhe vazhdimisht na thonë nëpër takime dhe nganjëherë zyrtarisht, që kanë mbetur edhe disa çështje dhe hajde t'i kryejmë, pastaj në plotësim ndryshim të dakordohemi që t'i marrim të gjitha sugjerimet në mënyrë që i njëjti të jetë i zbatueshëm ku kemi qindra ligje të cilat nuk janë të zbatueshme për shkak të rrethanave të cilat është Kosova dhe ka hapësira për shumë ligje për plotësim ndryshim, por për fazën në të cilën jemi kisha kërkuar nga ju kolegë deputetë mirëkuptim që ta kalojmë dhe mos ta kthejmë dhe ta dërgojmë një porosi se kemi mirëkuptim edhe për këtë pako shpresoj të fundit dhe të ecim tutje, amendamentimin e bëjmë bashkë në Kuvend.

**Armend Zemaj** tha po duket se është krijuar konfuzitet, ligji është në lexim të dytë dhe mundësia jonë ka qenë brenda dy muajve me bërë amendamente, nuk janë pranuar amendamentet të cilat kanë qenë substanciale, nuk e kanë marrë përkrahjen dhe ne jemi në linjë të drejtpërdrejtë me kërkesat e Komisionit Evropian. Po e parafrazoj vetëm një, konfiskimi i pasurisë në Kosovë është në pragun minimal për shkak të mungesës së hapësirës ligjore, deri sa ne me ligj e detyrojmë prokurorin me kërkuar fakte në Kosovë të njerëzit, të cilët kanë bërë pasuri të paligjshme, efektiviteti i këtij ligji është minimal. Jemi në përfundim dhe për këtë arsye po themi se nuk kemi pa vullnet të mazhorancës që pjesa kryesore që lidhet me identifikimin dhe faktimin të bjerë, ajo që quhet barra e provës tek i dyshuari, deri sa është kjo personalisht mendoj që nuk kemi me arritur efektivitetin e duhur në konfiskimin e pasurisë se fituar në mënyrë të pa ligjshme.

**Fatmire Kollçaku** tha se ne, si Kosovë, jemi në momentin se a duamë me bërë ligje me procedura të përshpejtuara të bazuara në kërkesat e BE-së, apo duam me bërë ligje të implementueshme për qytetarët e Kosovës, e jo me bërë vetëm ndryshime kozmetike.

Ju po shihni se liberalizimi nuk po ndodh pikërisht për këtë sepse ligjet nuk po gjejnë zbatim dhe pikërisht për këtë pastaj po shtojnë kushte. Opozita pikërisht është e interesuar ta kemi një ligj të mirëfilltë dhe nuk e japim votën kundër pa arsye dhe ne jemi të interesuar që të luftohet korrupsioni dhe krimi i organizuar sidomos institucional dhe pikërisht vërejtjen kryesore e kemi ashtu, siç e potencoi parafolësi se ku bie barra e provës.

Prandaj nëse Qeveria e ka seriozisht le ta sjellë një ligj të kompletuar i cili do të jetë në funksion të asaj që është kushti kryesor, jo vetëm për liberalizim të vizave. por edhe kushti kryesor për anëtarësim për të ardhmen në BE.

**Ismajl Kurteshi** tha se nëse BE-ja ka kërkuar aprovim të ligjeve që nuk e ndërrojnë gjendjen në terren atëherë kërkesa është e pa drejt dhe nuk e kisha përkrahur, por nuk e mendoj se e kanë kërkuar një gjë të tillë, por kanë kërkuar që nëpërmjet këtij ligji gjendja të ndërrojë në realitet. Nëse ky ligj është kriter shtesë për liberalizim të vizave, për mua është i pa pranueshëm sepse ato kritere janë plotësuar dhe nëse pranojmë edhe kritere të reja, nuk e di se ku do të ndalemi! Ajo që u tha nga kolegu Zenun se nuk është mirë para mediave me fol ndryshe, kurse pas mediave ndryshe, për mua kjo është dyfytërsi të cilën deputetët nuk duhet me bërë dhe në çdo rrethanë me u angazhuar punën me e krye si duhet dhe të flasim atë që është në interes të vendit dhe të bëjmë ligje që vihen në shërbim

të vendit për t'i luftuar dukuritë negative, siç është pasurimi i paligjshëm dhe me ligje kështu të cunguara nuk i ndihmojmë vendit, por përkundrazi i bëjmë dëm shumë më të madh se sa për të plotësuar diçka nëse është kriter shtesë për liberalizim të vizave.

**Donika Kadaj- Bujupi** tha se nuk kam thënë se është kriter shtesë, të gjithë ata që me dëgjuan kam thënë se kriteret janë plotësuar dhe ka pasur plot kritere të pa drejta dhe Qeveria është koordinuar me BE-në dhe këto takime tani që po ndodhin janë ne vazhden e përpjekjeve tona me e zënë hapin e fundit, por nëse dikush ka vendosur me e shfrytëzuar këtë moment dhe me e penguar atëherë përgjegjësia mbetet tek ata që po pengojnë dhe nuk e di se si deputetët dalin e thonë se ne nuk kemi bërë punë të mirë dhe kemi gabuar. Krejt procesi që ka të bëjë me kriteret janë përmbyllur edhe pse disa kritere kanë qenë të pa drejta dhe jemi në një fazë ku Qeveria me BE-në e ka intensifikuar një përpjekje dhe është hap i fundit dhe është kohë shumë e shkurtër dhe jemi në minutën e fundit, andaj po ju ftojme që ta kalojmë, e kemi mundësinë me iniciuar plotësim ndryshimin e ligjit.

**Zenun Pajaziti:** Mendoj se në komunitetin tonë politik ka pasur zëra dhe janë përmendur mosmiratimi i disa projektligjeve që kanë penguar rrugën tonë drejt integritit dhe njëri prej tyre ka qenë edhe ky, pra më mirë një version që mundemi me ndërruar diçka se sa mos me pas fare dhe nesër me dalë dhe me thënë nuk e kemi atë ligj! Sot e kemi mundësinë dhe jam për me miratuar. Ky projektligj dhe disa të tjerë janë kushte tona drejt procesit integruar, edhe po të mos të ishin kushte, ne duhet me i miratua për të mirën e vendit tonë.

**Blerta Deliu** tha se u potencua nga parafolësit se ky projektligj nuk është kriter për liberalizimin e vizave sepse Kosova i ka përmbush të gjitha kriteret, me klimën që po shoh në komision unë nuk po shoh mundësin që projektligji të kaloj dhe mendoj se nuk është mirë dhe kërkoj mirëkuptim nga kolegët deputetë që në këtë fazë ta kryejmë, jo për shkak të liberalizimit të vizave, por për shkak të agjendave evropiane të cilën e ka kërkuar edhe ambasadorja Apostolova që përfshihet në pakon e 4 projektligjeve si kërkesë e Komisionit Evropian që të miratohen për t'u përafuar me Agjendën e Reformave Evropiane.

Ne fund të nëntorit pritët që të ketë një rivlerësim të miratimit të ligjeve nga ana e institucioneve të BE-së që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, pra nëse fundi i nëntorit na gjen që nuk i kemi përmbushur këto obligime që i kemi marrë, atëherë si kryetare e komisionit kërkoj mirëkuptim që ne ta miratojmë këtë projektligj dhe mos të jemi si komision bllokues në këtë fazë.

**Armend Zemaj** tha se më tepër jeni duke u marrë me hipotetizime rreth situatës, ky ligj ekziston dhe është kërkuar një avancim, por unë nuk po e shoh kurrfarë avancimi dhe Qeveria e ka sjellë një ligj të ri, i cili është më i keq se ai i vjetri dhe kërkesat e deputetëve dhe te shoqërisë civile nuk janë të përfshira në këtë projektligj, edhe nëse vendos ky komision kundër, vendos vota e seancës plenare.

**Visar Ymeri** tha se është mirë që po e bëjmë një debat të tillë sepse këtu e kemi një mospajtim përmbajtjesor për ligjin, është gabim që në diskursin politik, cila do palë qoftë nga koalicioni qeverisës apo opozita, të thirret në emër të BE-së, sepse mendoj se kur fillojmë me e diskutuar këtë çështje do të shohim se ka mënyra të ndryshme të leximit se çka kërkohet nga ana e BE-së.

Mendoj se gjëja më e rëndësishme si Republikë e Kosovës është që t'i krijojmë kushtet legislative politike dhe shoqërore në të cilën do të kemi mundësi edhe institucionale që ta luftojmë krimin dhe korrupsionin, nëse të gjithë pajtohemi verbalisht që është problem, atëherë të gjithë duhet edhe të pajtohemi deri diku se cilat janë mekanizmat që do ta mundësonin një luftë të mirëfilltë të krimit dhe korrupsionit dhe në këtë drejtim nuk është se nuk kemi ligj për luftimin e krimit dhe korrupsionit, prej vitit 2012 e kemi, por edhe atëherë i kemi pasur të njëjtat vërejtje.

Ne fund u dëshmuar se ligji me këtë frymë me këtë plotësim- ndryshim nuk ka qenë i efektshëm, tash a po duam ne ta vazhdojmë të njëjtën frymë me të njëjtin Projektligj për të garantuar edhe një herë në 5 vitet e ardhshme një mos efektivitet të projektligjit?

Mendoj se për këtë nuk ka nevojë fare. Pastaj mendoj se me këtë lloj diskursi mund ta dëmtojmë shumë procesin e integriteteve evropiane. Për ligje të rëndësishme për mua me e domosdoshme është që ta kemi një diskutim të mirëfilltë se si do të dukej ligji dhe efektet e tij, se sa ngutja në kohë që na ka krijuar Qeveria që na ka sjellë ligjin me vonesë.

Mendoj se e kemi një situatë interesante, por demokratike, sepse nëse janë shumica në seancën plenare, pavarësisht çka themi ne, ky ligj do të kalojë, atëherë do të mësohemi se kompromisi politik është i domosdoshëm, pra këtu ka vërejtje nga opozita në çështje të caktuara dhe sa e pashë deri me tani një refuzim kategorik nga Koalicioni qeverisës që t'i pranojë këto vërejtje dhe mendoj se koalicioni duhet ta dijë që të bëjë kompromise në kërkesat e opozitës në rastet kur nuk ka mundësi ndryshe. Në rastet kur keni mundësi me e kaluar ligjin ne nuk mundemi me ju ndal, por nëse nuk keni mundësi me kaluar dhe prapë ju duhet vota e jonë atëherë duhet me na dëgjuar.

**Kryetarja** reagoj dhe tha, e para nuk e di që këtu pati dikush që u thirr në emër të BE-së, u tha që ka qenë kërkesë që në mesin e 4 ligjeve është edhe ky ligj dhe tash nuk po shoh refuzim kategorik të mazhorancës për me i pranuar vërejtjet e opozitës, por ne vetëm t'i kryejmë disa obligime si Komision për Integritete Evropiane.

**Visar Ymeri:** Nuk thashë nga ky komision ka refuzim për me i pranuar kërkesat e opozitës, por ka pasur refuzim kategorik nga Komisioni Funkcional për legjislacion, sepse ne në këtë komision nuk mund të ndërrojmë asgjë.

**Kryetarja** tha se ky komision e ka kërkuar vetëm vullnetin e mirë me e kaluar mos me qenë pengues, kurse sa i përket direktivave të BE-së ka qenë në përputhshmëri që është në fushëveprimin tonë dhe Komisioni për Legjislacion është marrë me debate.

**Donika Kadaj- Bujupi** tha se u keqkuptuam, nuk është ideja mos me i përfshirë amendamentet që janë të mirëfillta dhe prodhojnë ligj më të mirë, por nuk po e di se ku

kanë ngecur sepse nuk kemi qenë në Komisionin Funkcional dhe nuk e di se çfarë debati është bërë.

Por krejt çka po them është se në këtë fazë finale me e kthye në Qeveri është vonë, por hajde të merremi vesh dhe krejt jemi në rregull, por mos ta kthejmë si refuzim me na dalë mesazhi që Kuvendi parimisht e ka kthyer ligjin në Qeveri sepse nuk ka pasur vullnet për bashkëpunim.

**Ismajl Kurteshi** deri sot kemi funksionuar si komision i pa ndarë, pozitë –opozitë, sot deputetët e pozitës konstatuan se deputetët e opozitës po e bllokojnë ligjin, kjo nuk është e qëndrueshme sepse nuk kanë argumente, por vetëm sa po e dëmtojnë punën e komisionit. Ne nuk duhet këtu me folur me gjuhë politike, hajde ta kalojmë dhe të bëjmë kompromise! Ne duhet me folur për ligjin dhe na tregoni se cilat janë avancimet në këtë ligj krahasuar me ligjin e mëparshëm, nëse ka avancime dhe ne nuk po e kuptojmë! Na thoni nuk po e kuptoni dhe merreni nenin dhe amendamentin dhe na tregoni, përndryshe sa i përket rëndësisë se përgjithshme mendoj se nuk ka nevojë njëri- tjetrit t'i mbajmë ligjëratat, sinqerisht unë jam për liberalizimin e vizave, por jam kundër miratimit të këtij ligji sepse këtë e konsideroj si amnisti të atyre që janë pasuruar në mënyrë të pa ligjshme dhe jam kundër amnistisë së krimit të organizuar dhe korrupsionit, sepse ata njerëz pasurinë e kanë bërë për mes krimit dhe korrupsionit.

**Kryetarja** dhe Donika Kadaj-Bujupi kundërshtuan se nuk e thamë bllokadë, por thamë mos me penguar në këtë fazë, sepse është me rëndësi, është e vërtetë dhe e them prapë.

**Kryetarja** pas diskutimeve kërkoi nga anëtarët të deklarohen me votë për projektligjin.

Pas votimit konstatohet se Komisioni nxori këtë;

#### **Rekomandim**

**Nuk përkrahet Projektligji nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, me amendamentet e Komisionit Funkcional.**

**Arsyetimin e rekomandimit do ta paraqes Kryetarja e komisionit në seancë plenare.**

- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.**

**Kryetarja** tha se çështjet e rregulluara dhe të adresuara në këtë Projektligj nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj konstatohet se projektligji së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për seancë plenare.

Ajo lidhur me këtë Projektligj e hapi diskutimin.



**Visar Ymeri** kishte vërejtje në amendamentin 1, te neni 3, nënparagrafi 1.7 dhe ai tha se riformulimi është i pakuptimtë dhe nuk po e marr vesh çka kanë dashtë me thënë, ose është çështje lekturë apo e përkthimit.

**Armend Zemaj** tha në ligjin bazik janë dy lloje të sinjalizuesve, publik dhe privat, tani këta e kanë bërë ndarjen dhe i kanë lënë dy mekanizma të cilët këta i mbikëqyrin, njërin ja kanë dhënë Agjencisë Kundër Korrupsionit, kurse tjetrin ju kanë dhënë rregullatorëve dhe për këtë arsye duket i pa kuptueshëm.

**Kryetarja** pas diskutimeve kërkoj nga anëtarët te deklarohen me votë, pas votimit konstatoj se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

#### **Rekomandim**

**Projektligjit nr.06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është ne kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të procedohet për miratim në seancë plenare.**

#### **4. Të ndryshme**

**Kryetarja** njoftoi se vizita e delegacionit të Senatit Italian është anuluar, njoftoi edhe për vizitën e mundshme në Bundestagun Gjerman për të cilin është përgatitur një draft shkresë për ambasadën gjermane dhe pyeti nëse ka vërejtje apo propozime te pikat në shkresë, sepse brenda ditës duhet të përcillet.

Pasi nuk kishte asnjë propozim u vendos të përcillet e tillë në Ambasadën Gjermane.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

**Përgatitur nga:**  
**Njësia për mbështetjen e komisionit**

**Kryetare e komisionit,**  
**Blerta Deliu- Kodra**

-----